


DITËT E FUNDIT



E VËRTETË APO GËNJESHTËR

Në të vërtetë po ju them se ky brez nuk do të kalojë, pa u realizuar të gjitha këto. Qielli dhe toka do të kalojnë, por fjalët e mia nuk do të kalojnë. Mateu 24: 34-35

JANË PËRMBUSHUR

• Cilat janë shënjat e mbarimit të botës; (33 pas.K)

«Na thuaj, kur do të ndodhin këto gjëra? Dhe cila do të jetë shenja e ardhjes sate dhe e mbarimit të botës;» Mateu 24: 3

• Shkatërrimi i Jeruzalemit nga Romakët dhe shperndarja e Hebrenjve (70 pas.K.)

«Dhe kur do të shikoni Jeruzalemin të rrethuar nga ushtritë, ta dini se shkretime i saj është afër. Atëherë ata që janë në Jude....., Dhe ata do të bien nga tehu i shpatës, do t'i çojnë robër ndër të gjitha kombet.» Luka 21:20-24

«Në të vërtetë po ju them se të gjitha këto gjëra do të bien mbi këtë brez.»

Mateu 23:36

«Dhe gjithë populli duke u përgjigjur tha: "Le të jetë gjaku i tij mbi ne!." Mateu 27: 25

FILLIMI I DHIMBJEVE TË FUNDIT

• Por të gjitha këto gjëra janë fillimi i dhimbjeve të fundit Mateu 24: 8

Lufta e parë botërore 1914 –1918 pas.K

Lufta e dytë botërore 1939 – 1945 pas.K

Dukuri të llahtarshme nga qielli

«Por, kur të dëgjoni të flitet për luftëra dhe për ushime luftërash, mos u shqetësoni; sepse këto gjëra duhet të ndodhin; por nuk do të jetë ende mbarimi. Në fakt do të ngrihet kombi kundër kombit dhe mbretëria kundër mbretërisë»..... Marku 13: 7-8

.....do të ndodhin edhe dukuri të llahtarshme dhe shenja të mëdha nga qielli.» Luka 21: 11

• Hitleri i bën olokaustë Hebrenjtë (1940 –1944 pas. K)

«Atëherë Pilati, duke parë se nuk po arrinte gjë... lau duart para turmës, duke thënë: "Unë jam i pafaj për gjakun e këtij të drejti; mendojeni ju". Dhe gjithë populli duke u përgjigjur tha: "Le të jetë gjaku i tij mbi ne(70 pas K) dhe mbi fëmijët tanë!." (1940-1944) Mateu 27: 24-25

• Mbas 1878 vjetësh të shpërdarë rikrijimi i shtetit të Izraelit më 16-5-1948 pas. K

«Kur t'i çoj përsëri nga popujt dhe kur ti mbledh nga vendet e armiqëve të tyre dhe të shenjtërohen te ata në sytë e shumë kombeve, ata do të pranojnë që unë jam Zoti, Perëndia i tyre, që i çoi në robëri midis kombeve,

por që i ka mbledhur gjithashtu në vendin e tyre, duke mos lënë jashtë asnjë prej tyre» Ezekiel 39: 27-28

«Tani mësoni nga fiku... kur degët..... nxjerrin gjethet, ta dini se vera është afër.» Mateu 24: 32


• Tërmete-përmbytje-thatësira-uri-sëmundje-turbullira etj.

.....«... Sepse nga lart do të hapen ujëvara dhe themelet e dheut do të tronditen.»

Isaia 24: 18

«... do të ndodhin tërmete në vende të ndryshme (1960-2000 pas K. Po shtohen termetet 6,000%) (gjithashtu vdesin nga uria:4,000,000 njerëz) dhe turbullira. Këto gjëra nuk do të jenë tjetër veçse fillimi i dhembjeve të lindjes.»

Marku 13: 7-8



PËRMBUSHEN

• Jeruzalemi ;qyteti i debateve

«Ja, unë do ta bëj Jeruzalemin një kupë hutimi për gjithë popujt përreth;...dhe... një gur të rëndë për gjithë popujt...» Zakaria 12: 2-3

«... dhe Jeruzalemin do ta shkelin paganët, derisa të plotësohen kohët e paganëve» Luka 21: 24

• Paraqitja bashkimit evropian (BE) Kthimi në jetë i Perandorisë Romake

Mbretëria e katërt do të jetë e fortë si hekuri... copëton dhe thërrmon çdo gjë... Siç e pe, këmbët dhe gishtërinjtë ishin pjesërisht prej argjile poçari dhe pjesërisht prej hekuri... pjesërisht e fortë dhe pjesërisht e brishtë.Siç e pe hekurin të përzier me argjilën e butë, ata do të përzihen nga fara njerëzore, por nuk do të bashkohen njëri me tjetrin...» Danieli 2: 40-41-43



• Shpërthim i diturisë-teknologjia-rrugëtime nën ujë dhe në hapësirën ajrore

100 vjeçarin e fundit janë zbuluar dhe gjetur gjëra, shumë më tepër se 6.000 vitet e kaluara



«Por ti, Daniel, mbaji të fshehura këto fjalë dhe vulose librin deri në kohën e mbarimit; shumë njerëz do ta shfletojnë dhe dituria do të shtohet.» Danieli 12: 4



• Paraqitja e damkës 666

Tani më është e vendosur në të gjitha gjërat që tregtohen. Është e ashtuquajtura BARCODE me 3 kollona vijash që

janë 3 gjashtëshe, ku pa ato kompjuteri nuk mund ti njohë vijat në mes tyre. Çdo njëra vijë nga ata përfaqëson një numër. Është e ashtuquajtura numërimi elektronik.

«... dhe që askush të mos mund të blinte ose të shiste, po të mos kishte damkën ose emrin e bishës ose numrin e emrit të saj. dhe numri i tij është gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë (666)» Zbulesa 13: 17-18



• Kohë të këqija

Mëkati, Dhuna, Terrorizmi, Kriminaliteti, Imoraliteti, Droga

« ... Në ditët e fundit do të vijnë kohë të vështira,sepse njerëzit do të jenë egoistë,lakmues parash, mburracë, krenarë, blasfemues, të pabindur ndaj parinderve, mosmirënjohës, të paudhë, të padhemshur, të papajtueshëm, shpifës, të papërmbajtur, mizorë, që se duan të mirën, tradhëtarë, kokëshkretë, fodullë, dëfrimdashës më fort se perëndidashës, të perëndishëm në dukje, por mohues të fuqisë së sajë...» 2

Timoteu 3: 1-5



PËRMBUSHEN

• Toka do të infektohet

Përronjtë dhe detet do të infektohen, peshqit do ngordhin, ujërat e nëndheshëm do infektohen(mbeturinat toksike,etj) pyjet do të digjen (munges oksigjeni)

«Toka është në zi dhe vuan, bota po ligështohet dhe po meket, njerëzit me poste nga populli i dheut ligështohen. Toka është përdhosur nga banorët e saj, sepse këta kanë shkëlur ligjet, kanë ndryshuar statutin, kanë marrë nëpër këmbë besëlidhjen e përjetshme. Prandaj një mallkim e ka përpirë tokën dhe banorët e saj janë të dëshpëruar; prandaj banorët e tokës po digjen...».

Isaia 24: 4-6




• Rregulla të reja (globalizmi)

Ekonomike, Shoqërore, Kombëtare, Fetare dhe politike pa rrugëzgjidhje

«Sepse kur thonë:paqe dhe siguri,atëherë një shkatërrim i papritur do të bjerë mbi ta...» 1

Thesalonikasve 5: 3



• Mardhëniet njerëzore

Mungesë Dashurie, Mosinteresim, Vetmi, Braktisje, Shkurorëzime, Ankth Për të ardhmen, Vetëvrasje, Ilaçe Psikologjike.Eti.

«... Dhe, duke qenë se paudhësia do të shumohet, shumëkujt do t'i ftohet dashuria.» Mateu 24: 12

• Përhapja e Frymës së Shenjtë

«Dhe në ditët e fundit do të ndodhë, thotë Perëndia, që unë do të përhap nga Fryma ime mbi çdo mish; dhe bijtë tuaj e bijat tuaja do të profetizojnë... Sepse premtimi është për ju dhe për bijtë tuaj dhe për gjithë ata që janë larg, për ata që Zoti, Perëndia ynë, do t'i thërrasë» Veprat e Apostujve 2: 17,39

• Bekimi i madh i ditëve të fundit dhe predikimi i Ungjillit

«Në ditët e fundit do të vij që mali ku ndodhet shtëpia e Zotit do të vendoset në majën e maleve dhe do të ngrihet dibi disa kodra, dhe këtu do të vershojnë tërë kombet. Shumë popuj do të vijnë duke thënë: Ejani, në shtëpinë e Perëndisë ...; ai do të na mësojë rrugët e Tij» Isaia 2: 2-3

«Dhe ky ungjill i mbretërisë do të predikohet në gjithë botën si një dëshmi për gjithë kombet, dhe atëherë do të vijë mbarimi.» Mateu 24: 14

• Ndarja përfundimtare e njerëzve në besimtarë dhe jo besimtarë.

«Mos mendoni se unë erdha të sjell paqen mbi tokë ;nuk erdha të sjell paqen, por shpatën sepse unë erdha ta ndaj birin nga ati...» Mateu 10: 34-35

«Kush është i padrejtë le të vazdojë të jetë i padrejtë, kush është i ndyrë le të vazdojë të jetë i ndyrë, kush është i drejtë le të vazdojë të praktikojë drejtësinë, dhe kush është i shënjtë le të vazdojë të shënjtërohet.» Zbulesa 22: 11



DO TË PËRMBUSHEN

Rrëmbimi e kishës nga Jezus Krishti

• Premtoi se do të vijë përsëri

«... Dhe kur të shkoj e t'ju përgatis vendin, do të kthehem dhe do t'ju marr pranë meje, që aty ku jam unë, të jeni edhe ju.» Gjonit 14:3

• Ç'është rrëmbimi, dhe si do të ndodhë

«Nuk duam që të jeni në mosdije... ne të gjallët, që do të mbetemi deri në ardhjen e Zotit, nuk do të jemi përpara atyre që kanë fjetur, sepse Zoti vetë, do të zbresë nga qielli dhe ata që vdiqën në Krishtin do të ringjallen të parët; pastaj ne të gjallët, që do të kemi mbetur, pa u rrëmbehemi bashkë me ata mbi retë, për të dalë përpara Zotit në ajër.... Ngushëlloni, pra, njëri-tjetrin me këto fjalë.» 1 Thesalonikasve 4:13-18

• Kur do të bëhet rrëmbimi; vetëm Perëndia e di

«Tani sa për atë ditë dhe për atë orë, askush s'e di, as engjëjt e qieve, por vetëm Ati im...» Mateu 24:36

• Por edhe besimtarët e dinë se kur është afër

«... Kështu edhe ju, kur t'i shihni të gjitha këto gjëra, ta dini se ai është afër, madje te dera.... ky brez nuk do të kalojë, pa u realizuar të gjitha këto.» Mateu 24:33-34

• Ç'farë presin

Ashtu siç thuhet në sibolin e besimit; Pres ngjalljen e të vdekurve dhe jetën e amëshuar.Amen. «Prandaj, rriini zgjuar dhe lutuni kurdoherë që të çmoheni të denjë të shpëtoni nga të gjitha ato që do të ngjasin...» Luka 21:36

•Mos e humb këtë rast.

•Mos e humb rrëmbimin e kishës.

•Jepja zemrën tënde Krishtit dhe kërkoje atë. Do të të shpëtojë.

•E derdhi gjakun e tij për mëkatet e tua, për sëmundjet e tua dhe për mundimet e tua.

•Thirre Jezus Krishtin dhe ai do të ç'lirojë.

•Është i gjallë, besojë është i ringjallur, është e vërtetë.

•«DHE DO TË NDODHË QË KUSH TA KETË THIRRUR EMRIN E ZOTIT, DO TË SHPËTOHET»

Veprat e Apostujve 2:21

• Tempulli i Salomonit do të rindërtohet

«Ai do të lidhë gjithashtu një besëlidhje me shumë njerëz për një javë..., do t'i japë fund flijimit dhe blatimit; dhe mbi krahët e veprimeve të neveritshme do të vijë një shkatërrues...» Danieli 9:27

• Paraqitja dhe ngritja e antikrishtit

«... pa u shfaqur njeriu i mëkatit, i biri i humbjes, kundërshtari, ai që lartëson veten mbi çdo gjë që quhet perëndi ose objekt adhurimi, aq sa të shkojë e të rrijë në tempullin e Perëndisë si Perëndi, duke e paraqitur veten se është Perëndi.» 2 Thesalonikasve 2:3-4. • « Në fund, kur rebelët do ta kenë mbushur kupën, do të dalë një mbret me pamje të egër dhe i rrahur në dredhitë luftarake.» Danieli 8: 23

• Do të vijë nga djalli

«...Ardhja e atij të paudhi do të bëhet me anë të veprimt të Satanit, bashkë me çudira, shenja dhe mrekullish të rreme...» 2 Thesalonikasve 2: 9

• Shtatë vjeçari i diktaturës së antikrishtit

Damka 666 tek njerëzit

Damkën me tre gjashtat Antikrishti do ta vendosë në dorën e djathtë ose në ballin e njeriut. Njeriu do të bëhet një numër në një dosje të fuqishme elektronike ,të cilin Antikrishti mund ta kontrollojë, duke ja hequr atë që Perëndia i ka dhënë, domethënë lirinë e plotë të tij.

«Veç kësaj bëri që të gjithëve, të vegjël e të mëdhenj, dhe të pasur dhe të varfër, dhe të lirë dhe skllavër, t'u vihet një damkë mbi dorën e tyre të djathtë ose mbi ballin e tyre, dhe që askush të mos mund të blinte ose të shiste, po të mos kishte damkën ose emrin e bishës ose numrin e emrit të saj. Këtu është urtia. Ai që ka mend, le të bëjë llogari numrin e bishës, sepse është numër njeriu; dhe numri i tij është gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë.» Zbulesa 13: 16-18

DO TË PËRMBUSHEN

• Perëndia me dy profetët dhe me engjëj do të këshillojnë njerëzit të mos e vendosin damkën dhe të mos adhurojnë antikrishtin dhe figurën e tij.

«Dhe unë do t'u jap të dy dëshmitarëve të mi për të profetizuar, dhe ata do të profetizojnë një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë ditë, të veshur ...». Zbulesa 11: 3

«Një engjëll i tretë shkoi pas tyre duke thënë me zë të madh Nëse ndokush adhuron bishën dhe figurën e saj dhe merr damkën mbi ballin e vet ose mbi dorën e vet,... do të mundohet me zjarr e sqfur përpara engjëjve të shenjtë dhe përpara Qengjit». Zbulesa 14: 9-10

• Antikrishti do ti vrasë ata që nuk do të pranojnë të vendosin damkën dhe ta adhurojnë

«Fuqia e tij do të rritet, por jo për shkak të forcës së tij; do të bëjë shkatërrime të habitshme, do të ketë sukses në ndërmarrjet e tij dhe do të shkatërrtojë të fuqishmit dhe popullin e shenjtë.» Danieli 8: 24

Mundimi më i madh që do të ketë njerëzimi

• Antikrishti do të përdhosë tempullin e Salomonit

«Kur të shihni, pra, neverinë e shkretimit... , që ka zënë vend në vendin e shenjtë..., atëherë do të ketë një mundim aq të madh, sa nuk ka ndodhur kurrë që nga krijimi i botës e deri më sot, dhe as nuk do të ketë më kurrë!» Mateu 24: 15-21

• Lufta e tretë botërore kimikme dhe bërthamore

«... dhe nga gojë e tyre dilte zjarr, tym dhe sqfur. Nga këto të tri plagë u vra e treta e njerëzve...». Zbulesa 9: 16-17

• Zemërimi i Perëndisë

«Shkoni dhe derdhni mbi dhe kupat e zemërimit të Perëndisë ...ulqer e ligë..

çdo qenie e gjallë në det vdiq ..në lumenj dhe në burimet e ujërave dhe u bë gjak ..mbi diell; dhe ju dha atij të djegë njerëzit.. dhe mbretëria e tij u mbush me terr ; dhe njerëzit kafshonin gjuhët e tyre nga dhembja , dhe blasfemuan Perëndinë e qiellit për shkak të dhembjeve të tyre dhe ulqerët e tyre, por nuk u penduan për veprat e tyre....dhe u bë një termet i madh ,që i tillë nuk ishte bërë qëkurse u bënë njerëzit mbi tokë..., dhe qytetet e kombeve ranë.» . Zbulesa 16: 1-19



Ardhja e dytë e Jezus Krishtit

«Dhe do të vijë përsëri me lavdi të gjykojë të gjallët e të vdekurit,mbretëria e të cilit nuk do të ketë mbarim» Simboli i besimit

«...Sepse, si vetëtimat që del nga lindja dhe flakëron deri në perëndim, kështu do të jetë ardhja e Birit të njeriut.» Mateu 24: 27

«Dhe atëherë do të duket në qiell shenja e Birit të njeriut; dhe të gjitha kombet e dheut do të mbajnë zili dhe do ta shohin Birin e njeriut duke ardhur mbi retë e qiellit me fuqi dhe lavdi të madhe.» Mateu 24:30

«Ja, ai vjen me retë dhe çdo sy do ta shohë, edhe ata që e tejshpuan; dhe të gjitha fiset e dheut do të vajtojnë për të»

Zbulesa 1: 7

«... kur Zoti Jezus Krisht të shfaqet nga qielli me engjëjt e pushtetit të vet, në një zjarr flakëruar, për t'u hakmarrë kundër atyre që nuk njohin Perëndinë , dhe të atyre që nuk i binden ungjillit të Zotit tonë Jezus Krisht» 2 Thesalonikasve 1: 7-8

